



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
KOMISIONI PËR SIGURINË KOMBËTARE**

Tiranë më 17.06.2019
(Dokument parlamentar)

**RAPORT
PËR
PROJEKTLIGJIN “PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR.9900, DATË
10.4.2008, “PËR REZERVAT MATERIALE TË SHTETIT”**

- ***Hyrje***

Komisioni për Sigurinë Kombëtare, bazuar në nenet 32-36 të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e datës 17.06.2019, mori në shqyrtim projektligjin Shqyrtim i projektligjit “Për një ndryshim në ligjin nr. 9900, datë 10.04.2008, “Për rezervat materiale të shtetit”

Për shqyrtimin e këtij projektligji u caktua relatore deputetja Antoneta Dhima.

Për të bërë prezantimin e projektligjit në komision mori pjesë Zëvendësministri i Mbrojtjes z.Petro Koçi si dhe përfaqësues të tjerë nga Minisritria e Mbrojtjes.

- ***Vlerësimi i Ligjshmërisë Kushtetuese dhe harmonizimi me legjislacionin në fuqi dhe aktet ndërkombëtare.***

Projektligji “Për një ndryshim në ligjin nr.9900, datë 10.4.2008, “Për rezervat materiale të shtetit”, është në përputhje me Kushtetutën dhe në harmoni të plotë me legjislacionin në fuqi.

- ***Qëllimi, përmbajtja dhe risitë e projektaktit normativ***

Ndryshimi i propozuar në këtë projektligj ka për qëllim të thjeshtojë procesin e lëvrimit të mallrave rezervë shteti të grupit A, duke e zëvendësuar miratimin e lëvrimit të tyre me vendim të Këshillit të Ministrave me një akt individual, “Urdhër të Kryeministrit”. realizuar këtë marrëveshje, e cila krijon hapësira dhe mundësi më të mira për shtetasit e palëve kontraktuese për transport udhëtarësh, mallrash dhe dërgesash postare.

Ndryshimi i propozuar në këtë projektligj ka për qëllim të thjeshtojë procesin e lëvrimit të mallrave rezervë shteti të grupit A. Ligji aktual përcakton se:

– lëvrimi i mallrave të grupit A bëhet me vendim të Këshillit të Ministrave;
– lëvrimi i mallrave rezervë të grupit B bëhet me urdhër të ministrit, me propozimin e drejtorit të Përgjithshëm të Rezervave Materiale të Shtetit;

– mallrat rezervë të grupit C lëvrohen me urdhër të drejtorit të Përgjithshëm të Rezervave Materiale të Shtetit.

Lëvrimi i mallrave të grupit B dhe C bëhet me anë të një akti individual, “urdhër i ministrit” dhe “urdhër i drejtorit të Përgjithshëm”. Kjo mënyrë e bën më të lehtë e më të shpejtë lëvrimin e mallrave të grupeve përkatëse, sipas kushteve dhe rrethanave të parashikuara ligjërisht.

Për shkak se miratimi i lëvrimit të mallrave të grupit A bëhet nëpërmjet një akti kolegjal, si ai i vendimit të Këshillit të Ministrave, kjo sjell vonesa në daljen e aktit të miratimit dhe deri në lëvrimin e tyre.

Gjithashtu, ndryshimi i propozuar ka për qëllim unifikimin e procedurës së lëvrimit të mallrave rezervë shteti të secilit grup, nëpërmjet një akti individual hierarkik, duke filluar nga drejtori i Përgjithshëm- ministri dhe Kryeministri.

- ***Përfundime***

Komisioni për Sigurinë Kombëtare, pasi e shqyrtoi projektligjin në parim, nen për nen dhe në tërësi, me votat e të gjithë anëtarëve të pranishëm në mbledhje e miratoi atë duke vlerësuar se:

Në aspektin ligjor, projektakti i propozuar është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi.

Në aspektin procedural, projektakti është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit.

RELATOR

ANTONETA DHIMA

KRYETARE

ERMONELA VALIKAJ (FELAJ)